

VENDIM
Nr.1324, datë 1.10.2008

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË,
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR TË
NDËRTESES SË ISH-SPITALIT, POLIÇAN, DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.60,
DATË 1.2.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË
NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Shëndetësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror të ndërtesës së ish-spitalit, Poliçan.

2. Në listën e formularëve, që i bashkëlidhen vendimit nr.60, datë 1.2.2006 të Këshillit të Ministrave, të shtohet formulari me numrin rendor 32 “Qendra e trajtimit të fëmijëve, që vijnë nga familje në gjakmarrje”, në Poliçan, Skrapar, sipas tabelës dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËTËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)


Institucioni i pushtetit qendror: Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Bashkia: Poliçan							Identifikoi: Ing. Ardian Hasa Supervizoi: Pashë Dervishi, përgjegjës sektori Aprovoi: Vilma Premti, Drejtore e Përgjithshme			
A		B					C			
Nr. rendor	Zona kadastr.& indeksi i hartës	Nr. pasuri së	Lloji i pronës	Emri i pronës, adresa	Sip. totale e pronës (m ²)	Nga sip. totale sa ndërtesa	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/ enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/ enti përdorues statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
32	K 34-125		Truall ndërtese	Qendra e përkujdesit për fëmijë	3110 m ²	814 m ²	Shërbime për fëmijët	MPÇSSHB Drejt. Përgjith. Shërb. Sociale Shtetërore	Drejt.Përgjith. Shërbimit Sociale Shtetërore	2 Ndërtesa 2 kate dhe 4 katëshe

PLAN - VENDOSIA E ISH-SPITALIT

POLICAN S K R A P A R

SH.1:500

siperfaqija eshte 3110 m2



Plican,qershor 2008

PUNOI
INXH.Bujar Bundo
P. 2